



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Ekstra 44**

**Qershor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr.156, datë 21.3.2005

Për miratimin e marrëveshjes direkte për kalimin, transferimin ose krijimin e barrës siguroese, sipas Marrëveshjes Koncesionare, për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza”....

3

**VENDIM**  
**Nr.156, datë 21.3.2005**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES DIREKTE PËR KALIMIN, TRANSFERIMIN OSE KRIJIMIN E BARRËS SIGURUESE, SIPAS MARRËVESHJES KONCESIONARE, PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR “NËNË TEREZA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 35.2/b të nenit 5, të ligjit nr.9312, datë 11.11.2004 “Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “Tirana Airport Partners”, sh.p.k., për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe për dhënien e disa stimuljve kësaj shoqërie koncesionare, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë dhe të Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes direkte për kalimin, transferimin ose krijimin e barrës siguroese, sipas marrëveshjes koncesionare, për aeroportin ndërkombëtar “Nënë Tereza”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**QEVERIA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE TIRANA AIRPORT PARTNERS (TAP)**  
**(SHPK) DHE BANKA EUROPIANE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM**

**MARRËVESHJE DIREKTE**

**(PËR KALIMIN, TRANSFERIMIN OSE KRIJIMIN E BARRËS SIGURUESE SIPAS MARRËVESHJES KONCESIONARE PËR AEROPORTIN NDËRKOMBËTAR “NËNË TEREZA”**

Kjo Marrëveshje është bërë më ( ) 2005 ndërmjet:

1. Qeverisë së Republikës së Shqipërisë (Qeveria) e përfaqësuar nga Ministria e Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit të Republikës së Shqipërisë (bashkërisht Organi Shtetëror i Autorizuar);

2. Tirana Airport Partners (sh.p.k.), shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e organizuar dhe që ekziston në bazë të ligjeve të Republikës së Shqipërisë dhe e krijuar me vendim nr.32147, datë 20 shtator 2004, të Gjykatës së Rrethit Tiranë, me adresë të regjistruar në rr.e Kavajës nr.59, Tirana Tower, kati VII, Tiranë, Republika e Shqipërisë (Huamarrësi); dhe

3. Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim me adresë në One Exchange Square, London EC2A2JN, United Kindom (Banka).

Duke qenë se:

A) Sipas marrëveshjes së koncesionit të datës 15 tetor 2004 dhe të bërë ndërmjet Huamarrësit dhe Qeverisë, Huamarrësi do të projektojë, financojë, ndërtojë, do të vërë në punë, mirëmbajë, operojë, menaxhojë dhe zhvillojë Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” pranë Tiranës, Republika e Shqipërisë, për një periudhë 20 vjeçare që nga data e fillimit.

B) Në bazë të termave të marrëveshjes së termave të përbashkëta dhe marrëveshjeve suplementare të Huasë të kësaj date apo një date tjetër të afërt që janë lidhur midis Huamarrësit dhe bankave dhe institucioneve financiare të quajtura aty (në marrëveshje) si Huadhënësit, përfshirë Bankën (së bashku “Marrëveshja e huasë), Huadhënësit i sigurojnë Huamarrësit mjetet financiare për financimin e projektit (siç përcaktohet me poshtë).

C) Qeveria njeh dhe është dakord që Banka është e interesuar që Huamarrësi të vazhdojë të përmbushë detyrimet e tij në bazë të marrëveshjes së koncesionit. Po kështu, Qeveria ka rënë dakord t’i japë Bankës, *inter alia* disa të drejta për riparim shkeljesh të Huamarrësit në bazë të, dhe zgjidhjes

se, marrëveshjes së koncesionit, në përputhje me termat e kësaj marrëveshjeje.

D) Kjo është marrëveshja direkte të cilës i referohet marrëveshja e huasë.

E) Është një kusht, që i paraprin detyrimit të Bankës për të bërë disbursime ndaj Huamarrësit në bazë të marrëveshjes së huasë, që palët të hyjnë në këtë marrëveshje.

F) Banka hyn në këtë marrëveshje për dhe në emër të palëve financuese dhe mban përfitimin e kësaj Marrëveshjeje në trust për vete të dhe për palët financuese sipas termave të Marrëveshjes së Financimit.

Tani, për këtë arsye, palët bien dakord si më poshtë:

1. Përkufizime

1.1 Përkufizime

1.1.1 Në këtë dokument fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimin e dhënë në marrëveshjen e koncesionit:

Detyrime shtese	Rast i Çlirimit nga përgjegjësia
Ligji i koncesionit të Airoporit	Zgjerimi i pistës
Data e fillimit	Propozimi për zgjerimin e pistës
Rast i mospërbushjes nga shoqëria	Shërbimi i borxhit kryesor
Komiteti i pavarur i rishikimit	Organi shtetëror
Shkelje thelbësore	Shërbime të huasë së nënrenditur
Projekti	

1.1.2 Në këtë dokument, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

“AAEF” do të thotë Albanian-American Enterprise Fund, një organizatë jofitimprurëse krijuar dhe ekziston në bazë të ligjeve të Delaware (me numër regjistrimi ( ) dhe zyra të regjistruara në adresën 14 East 60 th Street, Suite 407, New York, NY 10022.

“Marrëveshja e termave të përbashkëta” do të thotë marrëveshja e termave të përbashkëta e datës \_\_\_\_\_, ose rreth datës së kësaj marrëveshjeje, ndërmjet Huamarrësit dhe Palëve Financuese.

“Kompensimi” do të thotë kompensimet lidhur me shërbimin e huasë kryesore dhe shërbimeve të huasë së nënrenditur që qeveria i paguan huamarrësit në bazë të termave të marrëveshjes së koncesionit, duke përfshirë (pa kufizim) klauzolat 25.2 (*Kompensimi për ndërhyrje*), 26.2 (Zgjidhja për shkak të vazhdimit të forcës madhore të tejzgjatur), 26.3(rasti i zgjidhjes së kontratës nga Qeveria e Shqipërisë për mospërbushje nga shoqëria) dhe 26.4 (rasti i zgjidhjes së kontratës nga Qeveria e Shqipërisë për mospërbushje nga shoqëria) dhe 26.4 (rasti i zgjidhjes së kontratës nga shoqëria për mospërbushje nga Qeveria e Shqipërisë).

“Marrëveshje koncesioni” do të thotë marrëveshja e koncesionit lidhur me dhënien e një koncesioni për Aeroportin Ndërkombëtar “Nënë Tereza” e datës 15 tetor 2004, bërë ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Huamarrësit.

“MBA e Kushtëzuar” do të thotë marrëveshja e kushtëzuar e blerjes së aksioneve të datës-ose rreth së njëjtës datë me këtë marrëveshje, ndërmjet sponsorëve dhe bankës.

“Periudha e përkujdesjes” do të thotë një periudhë 60-ditore nga data e marrjes në administrim.

“Njoftim i zbatueshmërisë” ka kuptimin e dhënë në klauzolën 4.1 të kësaj marrëveshjeje.

“Marrëveshjet qeveritare” do të thotë:

- Marrëveshja e koncesionit;
- Marrëveshja mbështetëse e aksionerëve; dhe
- Dokument tjetër që lidhet me projektin, në të cilin qeveria është ose do të bëhet palë.

“Borxhi i qeverisë” do të thotë detyrimet e Huamarrësit, qofshin ato ekzistuese në datën e kësaj marrëveshjeje, ose mbas kësaj date, për të bërë pagesat pranë qeverisë, duke përfshirë, pa kufizim, detyrimet e Huamarrësit për t’i paguar qeverisë.

a) Të shumave në bazë të Marrëveshjes së Koncesionit (duke përfshirë, pa kufizime dhe për mënjanimin e dyshimit, çdo shumë apo pagesa të llogaritura në përputhje me klauzolën 20 (*Pagesa për Qeverinë e Shqipërisë*) shtojca 4 (*Pagesat për Qeverinë e Shqipërisë – Shumat e Huasë Fillestare*). Shtojca 5 (*Penalitetet për mospërbushje të detyrimeve kryesore*) dhe shtojca 6 (*penalitetet për mospërbushje të detyrimit shtesë*);

b) të shumave të përcaktuara në marrëveshjen e mbështetjes së aksionerëve;

c) çdo pagesë tjetër nga Huamarrësi te qeveria; ose

d) çdo detyrim tjetër të çfarëdolloj natyre që Huamarrësi ka ose mund të ketë kundrejt qeverisë,

që rrjedhin nga të drejtat e veçanta, dëmshpërblime ose rimbursime, si rezultat of subrogation, në bazë të çdo marrëveshjeje ndërmjet qeverisë dhe huamarrësit ose tjetër.

“*Hochtief*” do të thotë *Hochtief Airport sh.p.k.*, një kompanie me përgjegjësi të kufizuar e krijuar dhe që funksionon në bazë të ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë, me numër regjistrimi 12919 dhe zyra të regjistruara në Alfredstrasse 236, 45133 Essen, Republika Federale e Gjermanisë.

“Periudha fillestare” do të thotë periudha prej 60 ditësh që fillon në datën e nisjes dhe që mbaron më përpara se (a) data e hyrjes dhe (b) dhënien e njoftimit sipas klauzolës 10.2 që Banka (në emër të Palëve Financuese) nuk ka qëllimin të ndërhyjë.

“Periudha e përgjegjshmërisë” do të thotë periudha që fillon nga data e kësaj Marrëveshjeje dhe mbaron pas pagimit të të gjitha shumave të mbetura hapur në bazë të Marrëveshjes së financimit.

“Humbje” do të thotë të gjitha humbjet direkte (duke përfshirë këtu dhe ato lidhur me shërbimet e huasë kryesore dhe taksa apo kosto të dëmtimeve) që u shkakton palëve financuese si dhe dëmtimet, detyrimet, kostot (duke përfshirë pa kufizim, kostot ligjore dhe taksat e ekspertëve dhe konsulentëve) tarifave, shpenzimet, veprimet, procedimet, pretendimet apo kërkesat që do të shfaqen nga këto humbje.

“Palët” do të thotë palët në këtë Marrëveshje.

“Borxhi kryesor” do të thotë detyrimet e Huamarrësit, qofshin ato ekzistuese në datën e kësaj marrëveshjeje ose që shfaqen pas kësaj date, për kryerjen e pagesave të principalit, interesave, taksave, tarifave, përqindjeve, dëmshpërblimeve dhe shumë të tjera kundrejt Palëve financuese sipas marrëveshjeve të financimit.

“Marrëveshja mbështetëse e aksionerëve” do të thotë marrëveshja mbështetëse e aksionerëve, e datës 15 tetor 2004 ndërmjet Huamarrësit, AAEF, Hochtief dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në bazë të së cilës AAEF dhe Hochtief kanë marrë përsipër kundrejt Qeverisë së Republikës së Shqipërisë kryerjen e disa veprimeve dhe kanë rënë dakord të sigurojnë kapitalin aksioner në lidhje me Huamarrësin.

“Data e hyrjes” ka kuptimin e dhënë në nenin 10.1 të kësaj marrëveshjeje.

“Njoftim për hyrje” ka kuptimin e dhënë në nenin 10.1 të kësaj marrëveshjeje.

“Data e daljes” do të thotë dita e parë pas përfundimit të periudhës së përkujdesjes.

“Njoftimi për zgjidhje” do të thotë njoftimi që i dorëzohet Bankës në përputhje me nenin 4.1 të kësaj marrëveshjeje.

“Data e nisjes” do të thotë, në lidhje me ndonjë shkelje të veçantë apo seri shkeljesh nga ana e Huamarrësit, data përpara datës së:

a) Dorëzimit të një njoftimi për zgjidhje pranë Bankës;

b) Dorëzimi të një njoftimi për zgjidhje pranë Qeverisë, dhe

c) Çdo ushtrim i të drejtave të ndërhyrjes së qeverisë, siç përshkruhen në klauzolën 14.1 (b) (ii) të marrëveshjes së koncesionit.

## 1.2 Interpretimi

Në këtë dokument, përveç rasteve kur konteksti kërkon ndryshe ose kur përcaktohet ndryshe:

1.2.1 Fjalët dhe frazat e përkufizuara ose të interpretuara, ose përkufizimet e të cilave janë përfshirë si referenca në marrëveshjen e termave të përbashkëta duhet të kenë të njëjtin kuptim dhe ndërtim dhe në këtë marrëveshje.

1.2.2 Referencat kundrejt një statusi apo dizpozite ligjore ose një direktive duhet të interpretohet, në çdo kohë të veçantë, sikur ajo përfshin një referencë për ndonjë modifikim, zgjerim apo rimiratim ligjor në çdo kohë që ka qenë në fuqi, dhe për të gjitha instrumentet, urdhërat dhe rregulloret që kanë qenë në fuqi dhe që hyn në fuqi në çdo kohë sipas vlefshmërisë, ose të derivuara nga vlefshmëria e statutit, dispozitës dhe direktivës përkatëse;

1.2.3 Referenca për klauzolat dhe shtojcat janë referenca të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

1.2.4 Referencat në njëjës duhet të përfshijnë dhe referencat përaktëse në shumës, si dhe e kundërta dhe fjalë që tregon person natyral duhet të përfshijë dhe çdo person tjetër;

1.2.5 Titujt do të injorohen gjatë interpretimit të kësaj marrëveshjeje;

1.2.6 Referenca kundrejt një marrëveshjeje, veprimi, instrumenti, licence ose dokumenti tjetër (duke përfshirë këtë marrëveshje) ose në një dispozitë e përfshirë në një nga sa më sipër, duhet të interpretohet, në kohën e veçantë, si një referencë e saj, siç mund të jetë shtuar, ndryshuar, amenduar, modifikuar, pezulluar apo ribërë; dhe

1.2.7 Referenca për palët përfshijnë pasardhësit e tyre, si dhe personat e caktuar të lejuar.

## 2. Marrëveshje të tjera

Në rast konflikti ose mospërputhjeje ndërmjet dispozitave të kësaj marrëveshjeje dhe dispozitave të ndonjë marrëveshjeje qeveritare, dispozitat e kësaj marrëveshjeje do të mbizotërojnë lidhur me përmbajtjen e konfliktit apo mospërputhshmërisë.

## 3. Miratimi për barrat siguruese

Qeveria bie dakord me barrat siguruese të dhëna nga Huamarrësi në favor të Bankës në bazë të dokumenteve të sigurisë, duke përfshirë, pa kufizime, ato mbi të drejtat, titullin përfitimet dhe interesat e Huamarrësit në dhe për marrëveshjet qeveritare. Qeveria e njeh dhe bie dakord, për sa më sipër në veçanti, pa kufizime, lidhur me dhënien e sigurisë mbi kuotat e Huamarrësit në favor të Palëve Financuese, dhe në këtë marrëveshje merr përsipër të pranojë dhe të bëjë përpjekje të arsyeshme për të lehtësuar çdo ushtrim të së drejtës së Bankës (në emër të Palëve Financuese) që rrjedh nga termat e kësaj marrëveshjeje ose të marrëveshjeve të financimit, për të shitur, të përdorë ose të kalojë këto kuota te Huamarrësit te palë të treta (palë) që të plotësojnë kriteret e shtojcës 12 (Investitorë strategjikë) të marrëveshjes së koncesionit, sipas përforcimit të një sigurie të tillë nga Banka (në emër të palëve financuese).

## 4. Njoftim për zgjidhje

### 4.1 Qeveria njeh dhe merr përsipër të:

4.1.1 Njoftojë Bankën me shkrim dhjetë ditë përpara se të dorëzojë pranë Huamarrësit njoftimin me shkrim për zgjidhje të marrëveshjes dhe

4.1.2 T'i japë Bankës një kopje të çdo njoftimi për zgjidhje me shkrim, që i është dorëzuar Huamarrësit, në bazë të termave të marrëveshjeve qeveritare, përfshirë, pa kufizime, në përputhje me klauzolat 3.6 (Mospërmbushja e kushteve paraprake), 26.2 (zgjidhje për shkak të forcës madhore të tejzgjatur) dhe 26.3 (zgjidhja) nga qeveria e Shqipërisë në rastet e veçanta të mospërmbushjes nga shoqëria) të marrëveshjes së koncesionit (secila e konsideruar "njoftim për zgjidhje). Në njoftimin për zgjidhje, qeveria do të shkruajë dhe dispozitën e marrëveshjes së koncesionit, mbi bazën e së cilës ajo e lëshon njoftimin për zgjidhje.

4.2 Në bazë të klauzolave 10.2 (në rastin e së cilës duhet të aplikohen dispozitat e klauzolës 10.3) dhe 12 të kësaj marrëveshjeje, njoftimi për zgjidhje i lëshuar nga qeveria në bazë të marrëveshjes së koncesionit, do të pezullohet dhe do të ketë efekt për zgjidhjen e marrëveshjes së koncesionit pas përfundimit të periudhës së përkujdesjes, dhe qeveria bie dakord dhe i zotohet Bankës, që nuk do të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të zgjidhur apo për të revokuar marrëveshjen e koncesionit deri në përfundimin e periudhës së përkujdesjes, me kusht që pezullimi:

4.2.1 Të mos përbëjë një dorëheqje të qeverisë e bazës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të ndërprerjes që gëzon ky i fundit, apo për ndonjë prishje apo ngjarje që përbëhen nga një bazë e tillë; dhe

4.2.2 T'u nënshtrohet pa paragjykime, dispozitave të tjera të kësaj marrëveshjeje.

## 5. Zbatueshmëria e palëve financuese

5.1 Banka, në emër të Palëve financuese, bie dakord dhe merr përsipër të njoftojë me shkrim menjëherë qeverinë për përshpejtime dhënieje shume, që është hua në bazë të Marrëveshjeve të Financimit dhe/ose të ndonjë procedimi tjetër detyruar të filluar lidhur me sigurinë që është pjesë përbërëse ose është sipas marrëveshjeve të financimit (një "njoftim zbatimi"). Qeveria pranon që ajo ka të drejtën vetëm të përcaktojë nëse Huamarrësi ka shkelur detyrimet e tij që rrjedhin nga marrëveshja financiare në lidhje me dispozita të veçanta të marrëveshjes së koncesionit (duke përfshirë, shmangien e dyshimeve dhe pa kufizime, sipas klauzolave 5.1 (a) dhe 28.1 (d) të marrëveshjes së koncesionit) pas marrjes së njoftimit të zbatimit.

5.2 Nëse Banka nuk bën njoftimin në bazë të klauzolës 5.1 atëherë e drejta e Palëve në bazë të kësaj marrëveshjeje ose e ndonjë pale tjetër financuese për të ndërmarrë veprime, të cilat Pala apo çdo palë tjetër financuese ka të drejtën të ndërmarrë kundër Huamarrësit lidhur me ngjarjen, shkakton përshpejtimin e pagesave të shumave të detyruara në bazë të marrëveshjeve të financimit dhe/ose fillimit të procedurave të zbatueshmërisë.

5.3 Në bazë të klauzolës 4 më sipër, qeveria bie dakord dhe i zotohet Bankës që nuk do të marrë hapa për ndërprerjen apo revokimin e marrëveshjeve qeveritare gjatë periudhës së përgjegjësisë.

## 6. Varësia

### 6.1 Varësia në të drejtën e pagesës

6.1.1 Pagesa e gjithë ose e një pjese të borxhit të qeverisë duhet të shtyhet dhe të kalohet në varësi të pagesës së plotë të borxhit kryesor dhe asnjë pagesë apo livrim tjetër nuk do të bëhet lidhur me pjesë të borxhit (duke përfshirë pa kufizime nëpërmjet *set-off* të shumave të cilat qeveria i ka borxh Huamarrësi) dhe asnjë pronë apo ndërtesë e Huamarrësit nuk do të përdoret për të blerë apo marrë pjesë të borxhit të qeverisë (i cili, për të mënjeluar dyshimin, do të shtohet dhe të bëhet e pagueshme nga Huamarrësi, në momentin pasi pagesa të lejohet në përputhje me termat e kësaj marrëveshjeje), deri kur borxhi kryesor të paguhet plotësisht.

6.1.2 Pavarësisht dispozitave të 6.1.1, Huamarrësi mund të bëjë pagesa për llogari të borxhit të qeverisë në përputhje me klauzolën 20 (pagesa për qeverinë e Shqipërisë) të marrëveshjes së koncesionit dhe gjokat në bazë të klauzolës 6.3 (d) dhe 6.3 (e) të marrëveshjes së koncesionit dhe të përlllogaritura sipas shtojcës 5 (gjoka për mospërbushje të detyrimeve bazë) dhe shtojca 6 (gjoka për mospërbushje të detyrimeve shtesë) (siç është e përshtatshme) e marrëveshjes së koncesionit deri sa nuk është bërë dhe vazhdon nisja dhe nëse këto pagesa lejohen në bazë të termave të marrëveshjes financiare.

## 6.2 Varësia në likuidim

Në rastin e zbatimit apo përforsimit të sigurisë, çdo shpërbërje, përshtjellim, likuidim, rirregullim, riorganizim ose procedime të tjera të ngjashme lidhur me Huamarrësin ose pronën e tij (vullnetarisht ose jo, të pjesshme ose të plota, nëse ndodhet në falimentin, paaftësi paguese, ose administrim i përkohshëm, ose mbi bazën e një caktimi për përfitim të kreditorëve ose të ndonjë renditjeje tjetër të aseteve dhe të përgjegjshmërive të Huamarrësit, ose tjetër) ose ndonjë shitje e të gjitha, ose substanciarisht të të gjitha aseteve të Huamarrësit, borxhi kryesor duhet të paguhet fillimisht i tëri përpara se qeveria të emërohet për të marrë apo mbajtur ndonjë pagesë apo livrim lidhur me borxhin e qeverisë. Në mënyrë që sa më sipër të zbatohet:

6.2.1 Të gjitha pagesat lidhur me borxhin e qeverisë, mbi të cilat qeveria ka të drejtë nëse borxhi i qeverisë nuk është dhënë në varësi sipas kësaj marrëveshjeje, do t'i bëhen direkt Bankës;

6.2.2 Qeveria, do të paraqesë menjëherë kërkesën apo kërkesat, sipas formatit të kërkuar, për të gjithë shumën e mbetur të borxhit të qeverisë dhe do të miratojë kërkesat, dhe t'i bëjë të gjitha pagesat dhe livrimet direkt Bankës;

6.2.3 Në këtë Marrëveshje, qeveria bie dakord në mënyrë të pakthyeshme që Banka ka të drejtë, sipas vendimit të saj, në emër të Qeverisë, të kërkojë të hedhë në gjyq, të mbledhë, të marrë dhe të japë faturime për secilën dhe të gjitha pagesat e tilla, ose livrimet, si dhe të skedojë, të vërtetojë dhe të votojë ose të bjerë dakord për procedime lidhur me kërkesat e qeverisë, që lidhen me borxhin e qeverisë; dhe

6.2.4 Në këtë marrëveshje, qeveria merr përsipër në mënyrë të pakthyeshme të bëjë përpjekjet e saj më të mira për zbatimin dhe fuqizimin e dispozitave të kësaj klauzole 6.2 dhe të veprojë në mënyrë të tillë që të sigurojë që borxhi kryesor të paguhet fillimisht i plotë, përpara se qeveria apo ndonjë palë tjetër fiton të drejtën të marrë apo tërheqë ndonjë pagesë, dhe në mënyrë që të mos preken interesat e palëve financuese në bazë të marrëveshjeve të financimit, në rast të ndonjë kryerjeje apo zbatimi të sigurisë, ndonjë zgjidhje, përfundim, likuidimin, rregullimi, riorganizimi apo procedime të ngjashme në lidhje me Huamarrësin apo pronën e tij, (si dhe përshkruar më sipër).

## 6.3 Trusti

Në rast se qeveria merr pagesë ose livrim tjetër të çdo lloji apo karakteri nga huamarrësi ose nga burim tjetër, për pjesë të borxhit të qeverisë, ndryshe nga sa lejohet shprehimisht në kushtet e kësaj marrëveshjeje, atëherë pagesa apo livrimi do të merret në formë trusi për Bankën dhe qeveria do të kthejë menjëherë pagesën apo lëvrimin te banka, në këtë moment trusti mbaron.

## 6.4 Aplikimi i pagesave

Pagesat dhe livrimet e marra nga Banka që lidhen me borxhin e qeverisë, kur merren në, ose konvertohen në kesh. Mund të aplikohet nga Banka fillimisht kundrejt pagesave për shpenzimet (përfshirë tarifa ligjore dhe shpenzime) të paguara ose sipërmarra nga Banka gjatë zbatimit të kësaj marrëveshjeje, ose në përpjekje të mbledhjes ose të arritjes së kryerjes së kësaj të fundit për ndonjë pjesë të borxhit të qeverisë, dhe çdo bilanc i kësaj duhet, vetëm ndërmjet qeverisë dhe Bankës, të aplikohet nga Banka, në mënyrë të tillë aplikimi, siç do të zgjedhë Banka, kundrejt pjesës së borxhit kryesor të mbetur të papaguar, me kusht, që gjithsesi, si midis Huamarrësit dhe kreditorëve të tij, të mos përkohen të bëhet pagesa ose livrime të çdo lloji apo karakteri lidhur me borxhin kryesor, dhe pavarësisht nga pagesat ose livrimet e kryera nga Banka lidhur me borxhin e qeverisë dhe të aplikuar

nga Banka për pagesën e borxhit kryesor, qeveria do t'u nënshtrohet të drejtave ekzistuese të Bankës, nëse ka, lidhur me borxhin kryesor deri në atë kohë kur kjo marrëveshje të ketë përfunduar siç është përcaktuar në klauzolën 20.1.

#### 7. Heqja dorë nga mbrojtja

7.1.1 Dispozitat e varësisë në këtë marrëveshje përbëjnë një varësi të vazhdueshme që i shërbejnë bilancit përfundimtar të të gjithë borxhit kryesor pavarësisht nga çdo pagesë e ndërmjetme apo lëshim të çdo shume të borxhit kryesor.

7.1.2 Dispozitat e varësisë në këtë marrëveshje dhe detyrimet e qeverisë në këtë marrëveshje nuk do të ndikohen nga akte, heqje dorë, çështje apo send e cila, vetëm për këtë nen, do të pakësojë, lejojë ose çënojë varësinë e detyrimeve të saj (qoftë të plotë apo të pjesshme) në bazë të kësaj marrëveshjeje (pa kufizime dhe nëse janë apo të njohura prej saj apo çdo pale financiare) duke përfshirë:

- i) Pavlefshmëri apo parregullsi e plotë apo e pjesshme e çdo marrëveshje financiare;
- ii) Heqje dorë nga Banka lidhur me performancën ose respektimin nga Huamarrësi të marrëveshjeve, kontratave, termave apo kushteve të përfshira në marrëveshjet financiare;
- iii) Çdo vonesë në apo zgjatjen e afatit për pagesat nga ana e Huamarrësit të shumave të pagueshme në bazë të apo në lidhje me çdo marrëveshje financiare ose të afatit për përmbushjen e çdo obligimi tjetër nga Huamarrësi nën apo që rrjedhin nga ose jashtë marrëveshjeve financiare apo zgjatja ose rinovim prej saj.
- iv) Ndryshimin ose amandimin (qoftë material apo ndryshe) të detyrave, marrëveshjeve apo obligimeve të Huamarrësit të përcaktuar në marrëveshjen financiare apo të likuidimit të pavullnetshëm, shitjes apo përdorim tjetër të aseteve të Huamarrësit.
- v) Bllokimi i pasurisë, paaftësia paguese, falimentimi, riorganizimi ose procedura të tjera të ngjashme që ndikojnë Huamarrësin dhe asetet e tij;
- vi) Shkarkimin apo lirim, pa miratim e Bankës, e Huamarrësit nga përmbushja ose respektimi i marrëveshjeve, kontratave, afateve apo kushteve të përfshira në marrëveshjen financiare;
- vii) Konsolidimin apo shkrirjen e Huamarrësit; ose
- viii) Shkaqe ose rrethana të tjera, të ngjashme ose të ndryshme nga paraprirësja, që mund të përbëjë një mbrojtje, për ose lirim e qeverisë.

#### 8. Informacioni mbas datës së nisjes

8.1 Brenda dhjetë (10) ditëve nga data e nisjes, qeveria duhet ta njoftojë Bankën me shkrim për:

8.1.1 Shumat që janë të pagueshme nga Huamarrësi për Qeverinë në bazë të marrëveshjeve qeveritare, në formën e saj në ditën e nisjes;

8.1.2 Përgjegjshmëri që rrjedhin për Huamarrësin nga marrëveshjet qeveritare, duke përfshirë detyrimet e papërmbushura të performancës së Huamarrësit, në ditën e nisjes, për të cilën Qeveria është në dijeni; dhe

8.1.3 Informacion mbështetës për çështje të cilave u referohet në klauzolat 8.1.1 dhe 8.1.2 më sipër dhe informacion tjetër shtesë, që Banka mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme herë pas here.

8.2 Qeveria nuk ka të drejtën të ngrejë pretendimet lidhur me përgjegjshmëritë e Huamarrësit që shfaqen përpara datës së dhënies së njoftimit nga qeveria në bazë të klauzolës 8.1 dhe që nuk përmendet në njoftim.

#### 9. Programi riparues

9.1 Brenda njëzet (20) ditëve nga data e nisjes, ose më vonë brenda dhjetë ditëve pas marrjes së njoftimit në bazë të klauzolës 8.1 dhe nëse Banka i ka dhënë njoftim qeverisë sipas klauzolës 10.2 (në të cilin rast do të aplikohen dispozitat e klauzolës 10.3), qeveria dhe Banka do të takohen dhe në mirëbesim e të përpiqen e të bien dakord mbi një program të përbashkët për riparimin e detyrimeve të performancës të mbetura hapur të Huamarrësit, në bazë të marrëveshjeve qeveritare, si në ditën e nisjes.

9.2 Çdo dështim në rënie dakord mbi programin riparues si përshkruhet në klauzolën 9.1 nuk do të prekë apo çënojë të drejtat e Bankës të Palëve financuese në bazë të kësaj marrëveshjeje.

#### 10. Njoftim për ndërhyrje

10.1 Banka mund të japë njoftimin (një "Njoftim për ndërhyrje") me shkrim pranë qeverisë në çdo kohë gjatë periudhës fillestare, për qëllimin e Bankës (në emër të palëve financuese) për bërjen e përzjekjeve të arsyeshme për prokurimin e performancës së vonuar të detyrimeve të performancës së

Huamarrësit sipas marrëveshjeve qeveritare, të cilat janë shfaqur përpara datës së njoftimit për hyrje dhe janë njoftuar nga ana e qeverisë sipas klauzolës 8.1, atëherë njoftimi për hyrje do të bëhet efektiv në një datë të përcaktuar për këtë të fundit, ose përpara mbarimit të periudhës fillestare (data në të cilën një njoftim i tillë bëhet efektiv do të jetë “Data e ndërhyrjes”).

10.2 Mbas shfaqjes së një date nisje dhe gjatë periudhës fillestare, Banka mund në çdo kohë, përpara dhënies së njoftimit për ndërhyrje, ta njoftojë qeverinë që palët financuese nuk kanë ndërmend të ushtrojnë të drejtat e tyre ndërhyrëse në bazë të kësaj marrëveshjeje.

10.3 Pas marrjes së njoftimit sipas klauzolës 10.2 më sipër, Qeveria do të, brenda 30 ditëve pas marrjes së njoftimit, ose të ushtrojë të drejtën e qeverisë për zëvendësim sipas klauzolës 32.2 (zëvendësimi nga ana e qeverisë së Shqipërisë) të marrëveshjes së koncesionit ose do të ndërpresë marrëveshjen e koncesionit në bazë të dispozitës së marrëveshjes së koncesionit të përcaktuar në njoftimin për mbarim lëshuar në përputhje me klauzolën 4.1. Në çdo rast qeveria do t’i paguajë kompensimin drejtpërdrejt bankës (në emër të palëve financuese).

10.4 Pa cenuar të drejtat e Bankës dhe të palëve financuese në bazë të klauzolës 10.3 më sipër, nëse brenda 60 ditëve pas dorëzimit të njoftimit në bazë të klauzolës 10.2 më sipër, qeveria nuk i ka paguar bankës kompensimin, atëherë qeveria njeh dhe konfirmon faktin që banka ka të drejtën (në emër të palëve financuese) të zbatojë sigurinë mbi asetet dhe kuotat e huamarrësit.

#### 11. Të drejtat e ndërhyrjes

11.1 Banka mund, gjatë periudhës së përkujdesjes, siç është specifikuar në klauzolën 32 të marrëveshjes së koncesionit:

11.1.1 Të ushtrojë të drejtat e Huamarrësit dhe të zbatojë detyrimet e Huamarrësit që rrjedhin nga marrëveshjet qeveritare;

11.1.2 Të ndërmarrë hapat për shitje, transferim, ose t’ia kalojë ndryshe kuotat e huamarrësit një pale të tretë blerësit, e cila plotëson kriteret e shtojcës 12 (investitore strategjike) të marrëveshjes së koncesionit.

11.1.3 Të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme ligjore, financiare dhe teknike që i japin mundësi Huamarrësit të përmbushë detyrimet e tij në bazë të marrëveshjeve qeveritare, përfshirë pa kufizim 1) emërimin e drejtuesve të rinj/ose stafit; 2) emërimin e nënkontraktorëve të rinj dhe/ose nën nënkontraktorëve (së bashku të quajtur “Ristrukturim”).

11.1.4 Të anulojë njoftimin për ndërhyrje në fuqi, pasi njofton me shkrim 15 ditë biznesi përpara qeverinë, dhe pas mbarimit të periudhës së këtij njoftimi:

i) do të përfundojë dhe periudha e përkujdesjes përkatëse, dhe

ii) Banka (në emër të palëve financuese) do të çlirohet nga të gjitha përgjegjësitë që rrjedhin nga njoftimi për ndërhyrje, periudha e përkujdesjes, dhe nga kjo klauzolë.

11.2 Periudha e përkujdesjes do të përfundojë në datën e përcaktuar në njoftimin me të cilin Banka njofton qeverinë për përfundimin e veprimeve mbrojtëse, si është rënë dakord në bazë të klauzolës 9.1 zbatuar në bazë të klauzolës 11.1 apo në bazë të ristrukturimit (“Datën e njoftimit të përkujdesjes”) dhe qeveria nuk do të ketë asnjë të drejtë pas kësaj date të ndërpresë marrëveshjet qeveritare për asnjë shkak apo ngjarje, veprim, ose harresë që ndodh përpara përfundimit të periudhës së përkujdesjes.

11.3 Për të shmangur dyshimin dhe në mbështetje të kësaj klauzole 11, shkeljet thelbësore ose rastet e mospërmbushjeve nga shoqëria sipas klauzolës 26.3 të marrëveshjes së koncesionit do të konsiderohen të shlyera pas datës së përfundimit të veprimeve riparuese ose shitjeve, transferimit apo, dhënie sipas klauzolës 11.2 ose ristrukturim sipas klauzolës 11.1.3.

11.4 Gjatë periudhave të përkujdesjeve, qeveria bie dakord dhe merr përsipër kundrejt Bankës që:

11.4.1 Nuk do të ndërpresë ose dorëzojë njoftim zgjidhjeje lidhur me marrëveshjet qeveritare, përveç në rastin e mospërmbushjeve të re të Huamarrësit që i jep të drejtën Qeverisë ta bëjë këtë, në lidhje me të cilin, njëkohësisht do të zbatohen dhe të drejtat e ndërhyrjes së Bankës (në emër të palëve financuese) që rrjedhin nga klauzolat 8 deri 10 (duke i përfshirë këto të dyja).

11.4.2 Nuk do të ndalojë, pengojë ose vështirësojë zbatimin nga Huamarrësi, palë të treta blerëse, Banka apo person tjetër, të të drejtave dhe detyrimeve të Huamarrësit, në bazë të kësaj marrëveshjeje dhe të marrëveshjeve qeveritare.

#### 12. Mbarimi

12.1 Në datën e mbarimit, Banka do të lirohet nga të gjitha detyrimet dhe përgjegjësitë



kundrejt qeverisë, që shfaqen përpara datës së mbarimit.

12.2 Huamarrësi do të vazhdojë të qëndrojë i detyruar nga kushtet e marrëveshjes së koncesionit, pavarësisht datës së mbarimit.

13. Marrja përsipër nga qeveria

13.1 Qeveria bie dakord dhe merr përsipër kundrejt Bankës:

13.1.1 Të përmbushë detyrimet e saj në bazë të marrëveshjeve qeveritare.

13.1.2 T'i dorëzojë Bankës në të njëjtën kohë dhe Huamrrësit, një kopje të të gjitha njoftimeve, konfirmimeve, shënimeve të shkruara dhe informacione të tjera me rëndësi thelbësore që qeveria i dorëzon Huamarrësit në bazë të marrëveshjes së koncesionit.

13.1.3 Të pranojë si të vlefshme njoftimin apo kërkesën e dhënë ose të bërë nga Banka, nga një marrës, ose menaxher, ose ndonjë zyrtari gjykatë, i caktuar sipas marrëveshjeve të financimit, në vend të Huamarrësit.

13.1.4 Përveç kur ka miratimin me shkrim të Bankës, ajo nuk do të bjerë dakord me, apo të marrë pjesë në një veprim të Huamarrësit, i cili do të binte në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes financiare.

13.1.5 Përveç kur ka miratimin me shkrim të Bankës, ajo nuk do të bjerë dakord të bëjë ndryshime thelbësore në marrëveshjet qeveritare, si dhe të mos bjerë dakord me lirim apo heqjen dorë të Huamarrësit nga termat, dispozitat apo kushtet e marrëveshjeve qeveritare.

13.1.6 Që ajo do ta njoftojë Bankën sa më shpejt të jetë e mundur pas marrjes së informacionit ose njoftimit për ngjarje që do të mund, nëse do të vazhdonin pas dhënies së njoftimit dhe/ose mbarimit të ndonjë periudhe faljeje, të rezultonte në ngjarje që i japin të drejtë qeverisë të ndërpresë marrëveshjen e koncesionit;

13.1.7 Që opinioni ligjor që do t'i sigurohet Huamarrësit në bazë të 3.2 (b) (i) të marrëveshjes së koncesionit nga Ministri i Drejtësisë së Republikës së Shqipërisë i) do të përfshijë gjithashtu një opinion, në formën dhe përmbajtjen e kënaqshme për Bankën (në emër të palëve financuese) që konfirmon se marrëveshja është zbatuar saktësisht në emër të qeverisë nga organi shtetëror i autorizuar, i cili ka fuqi të plotë dhe autoritet për ta zbatuar në emër të qeverisë dhe ii) t'i adresohet palëve financuese, dhe qeveria pranon që palët financuese do të kenë të drejtën të mbështeten mbi këtë opinion;

13.1.8 Nëse, në përputhje me klauzolën 3.6 (b) të marrëveshjes së koncesionit, data e fillimit nuk ndodh brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi dhe efektshmërisë së ligjit të koncesionit të aeroportit, për shkak të dështimit të qeverisë për të përmbushur detyrimet e saj nën klauzolën 3.2 (kushtet paraprake të qeverisë së Shqipërisë), qeveria do të dëmshpërblejë palët financuese për çdo humbje të shkaktuar si pasojë, për aq sa kjo humbje nuk është kompensuar në ndonjë mënyrë tjetër dhe

13.1.9 Nëse, sipas klauzolës 23 (d) të marrëveshjes së koncesionit, Huamarrësi pretendon shfaqjen e një ngjarjeje suplementare, Qeveria duhet të përcaktojë menjëherë (ose të marrë konsulencë për përcaktimin) humbjen e Huamarrësit, shkaktuar nga ngjarja e pretenduar suplementare dhe duhet të bëjë menjëherë pagesat me shërbimet e borxhit kryesor siç është përcaktuar në klauzolën 23 (d) të marrëveshjes së koncesionit.

13.2 Në këtë marrëveshje, qeveria i konfirmon Bankës që në atë datë, ose përpara kësaj date nuk ka marrë njoftim tjetër për detyra, tarifa, garanci, hipoteke, ose barrë tjerë për ose në lidhje me interesat e sigurisë të dhëna nga Banka sipas marrëveshjeve të financimit.

13.3 Qeveria njeh dhe konfirmon që Huamarrësi mund të mbajë llogari bankare projekti në Republikën e Shqipërisë ose jashtë saj, në monedhën që ai vetë zgjedh dhe që Huamrrësi mund të shesë dhe të blejë monedha të huaja në përputhje me ligje të aplikueshme për transaksione të tilla dhe që Banka (në emër të palëve financuese) ka të drejtën të mbështetet në këtë konfirmim dhe njohje përpara dorëzimit të një njoftimi detyrimi.

13.4 Qeveria njeh dhe konfirmon që Banka (në emër të palëve financuese) mund të bazohet dhe të zbatojë klauzolën 4.2 (q) të Marrëveshjes së Koncesionit njësoj sikur kjo dispozitë të përsëritej (*mutatis mutandis*) në këtë marrëveshje.

13.5 Në varësi të së drejtës së qeverisë për të ndërprerë marrëveshjen e koncesionit sipas klauzolës 32.1 (a) të marrëveshjes së koncesionit, qeveria njeh dhe konfirmon (i) që Banka (në emër të palëve financuese) mund të bazohet dhe të zbatojë si për qeverinë, ashtu dhe për Huamarrësin, klauzolën 14.1 (b) (iii) të marrëveshjes së koncesionit, njësoj sikur kjo dispozitë të përsëritej (*mutatis*

*mutandis*) në këtë marrëveshje dhe (ii) që të drejtat për ndërhyrje të qeverisë (ose sipas klauzolës 14.1 (b) (iii) të marrëveshjes së koncesionit ose ndryshe) ose të drejtat e zëvendësimit që ka Qeveria sipas klauzolës 32.2 (Zëvendësimi nga ana e Qeverisë së Shqipërisë) të marrëveshjes së koncesionit mund të ushtrohet vetëm pas njoftimit me shkrim të Bankës dhe u nënshtrohen të drejtave ndërhyrëse të Bankës sipas klauzolës 10 dhe 11 të kësaj Marrëveshjeje.

13.6 Qeveria njih dhe konfirmon që banka (në emër të palëve financuese) mund të bazohet dhe të zbatojë klauzolën 20 (c) të marrëveshjes së koncesionit njësoj sikur këto dispozita të përsëriteshin (*mutatis mutandis*) në këtë marrëveshje.

13.7 Në vartësi të së drejtës së Bankës (në emër të palëve financuese) për shitjen e kuotave të Huamarrësit sipas klauzolës 11.1.2 të kësaj marrëveshjeje, qeveria njih dhe konfirmon që Banka (në emër të palëve financuese) mund të bazohet dhe të zbatojë klauzolën 32.1 (b) të marrëveshjes së koncesionit njësoj sikur kjo dispozitë të përsëritej (*mutatis mutandis*) në këtë marrëveshje.

13.8 Qeveria njih dhe konfirmon që Banka (në emër të palëve financuese) ka të drejtën për kompensim sipas, dhe mund të bazohet dhe zbatojë dispozitat e klauzolave 25.2 (a), 25.2 (b), 26.1 (ndërprerja pas ndërhyrjes), 26.2 (ndërprerja për shkak të forcave madhore të tejzgjatura) dhe 26.3 (ndërprerja nga ana e Qeverisë së Shqipërisë për shkak të rasteve specifike të mospërmbushjes së kompanisë) njësoj sikur këto dispozita të përsëriteshin (*mutatis mutandis*) në këtë Marrëveshje.

13.9 Qeveria njih dhe merr përsipër që të gjitha pagesat e kompensimit sipas kushteve të marrëveshjes së koncesionit do të kryhen të plota dhe pa zbritje, në konto bankare që Banka do të specifikojë për qeverinë, në një kohë të tillë të përshtatshme për detyrimet e qeverisë kundrejt huamarrësit, sipas kushteve të marrëveshjes së koncesionit.

#### 14. Detyrimet shtesë dhe zgjerimi i pistës

14.1 Qeveria njih dhe konfirmon që detyrimet shtesë të Huamarrësit mund të rrjedhin vetëm nga dispozitat e klauzolës 4.5 (Zbatimi dhe rishikimi i detyrimeve shtesë të kompanisë) të marrëveshjes së koncesionit dhe që detyrimet e huamarrësit në lidhje me zgjerimin e pistës mund të rrjedhin vetëm nga dispozitat e klauzolës 4.8 (zgjerimi i pistës) të marrëveshjes së koncesionit.

14.2 Qeveria njih dhe konfirmon që sipas klauzolës 4.5 (a) të marrëveshjes së koncesionit, huamarrësi duhet të marrë miratimin e Bankës (në emër të Palëve Financuese) përpara hyrjes në fuqi të detyrimeve shtesë, të cilat do të përbëjnë detyrime të huamarrësit sipas marrëveshjes së koncesionit, dhe që miratime të tilla të mos vonohen apo të mbahen pa arsye.

Përshtatshme për detyrimet e qeverisë kundrejt huamarrësit, sipas kushteve të Marrëveshjes së Koncesionit.

#### 14. Detyrimet shtesë dhe zgjerimi i pistës

14.1 Qeveria njih dhe konfirmon që detyrimet shtesë të Huamarrësit mund të rrjedhin vetëm nga dispozitat e klauzolës 4.5 (Zbatimi dhe rishikimi i detyrimeve shtesë të Kompanisë) të marrëveshjes së koncesionit dhe që detyrimet e huamarrësit në lidhje me zgjerimin e pistës mund të rrjedhin vetëm nga dispozitat e klauzolës 4.8 (zgjerimi i pistës) të marrëveshjes së koncesionit.

14.2 Qeveria njih dhe konfirmon që sipas klauzolës 4.5 (a) të marrëveshjes së koncesionit, huamarrësi duhet të marrë miratimin e Bankës (në emër të Palëve Financuese) përpara hyrjes në fuqi të detyrimeve shtesë, të cilat do të përbëjnë detyrime të huamarrësit sipas marrëveshjes së koncesionit, dhe që miratime të tilla të mos vonohen apo të mbahen pa arsye.

14.3 Qeveria njih dhe konfirmon që propozimi financiar lidhur me zgjerimin e pistës që do të përgatitet nga Huamarrësi sipas klauzolës 4.8 (a)(iii) të marrëveshjes së koncesionit, do të miratohet nga Banka (në emër të palëve financuese) përpara se propozimi për zgjerim piste të dorëzohet për vlerësim pranë Komitetit të Pavarur të Vlerësimit sipas klauzolës 4.8 (b) të marrëveshjes së koncesionit.

14.4 Qeveria njih dhe konfirmon që Banka (në emër të palëve financuese) duhet të miratojë me shkrim, që miratimi të mos vonohet në mënyrë të paarsyeshme, rekomandimin e Komitetit të Pavarur të Vlerësimit për propozimin për zgjerim piste përpara se kjo ti dorëzohet qeverisë sipas klauzolës 4.8(b) të marrëveshjes së koncesionit.

#### 15. Siguracioni

Qeveria është dakord që Banka (në emër të palëve financuese) të ketë të drejtën, me kërkesën e saj, të hyjë si *loss payee* në të gjitha policat e siguracionit të nxjerra lidhur me projektin (nga Huamarrësi ose nga qeveria në emër të tij) dhe nëse sipas klauzolës (detyrimet e sigurimit) të marrëveshjes së koncesionit, marrëveshjeve të financimit, ose ndryshe, Banka duhet t'i ketë këto të

drejta lidhur me procedimet për veprime të siguracionit që kërkohen të kenë efekt dhe të mirëmbahen nga ose në emër të Huamarrësit sipas marrëveshjes së koncesionit dhe marrëveshjes së huasë siç janë dhënë në shtojcën 1 të kësaj marrëveshjeje.

#### 16.Njohja dhe miratimi i huamarrësit

Huamarrësi merr pjesë në këtë marrëveshje për të njohur dhe të miratuar kushtet e përcaktuara në të dhe bie dakord të përmbushë detyrimet e tija që rrjedhin nga kjo marrëveshjeje, të asistojë Bankën duke ushtruar të drejtat apo fuqitë që i jepen Huamarrësit në bazë të kësaj marrëveshjeje, dhe të mos bëjë apo të harrojë të bëjë diçka që mund të pengojë ndonjë palë në zbatimin e të drejtave të saj në bazë të kësaj marrëveshjeje

#### 17.Me shumë se një ndërhyrje

Për të mënjeluar dyshimin, asgjë në këtë marrëveshje nuk duhet të ndalojë Bankën të ndërmarrë veprimet e përshkruara në klauzolat 10 dhe 11 më shumë se një herë, me kusht që, përveç rasteve kur ka gabim të dukshëm, mund të jepet vetëm një njoftim për zgjidhje.

#### 18.Përfaqësimet dhe mandatet

Qeveria përfaqëson dhe garanton që në datën e kësaj marrëveshjeje:

18.1 Statuti është përfaqësuar në mënyrë të vlefshme nga Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit, të cilat janë të dyja organe ligjore, të krijuara dhe ekzistuese në përputhje me ligjet e Shqipërisë.

18.2 Fuqitë dhe autoriteti: ka fuqinë të hyjë dhe të performojë, dhe ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për autorizimin e hyrjes në fuqi dhe për zbatimin e kësaj marrëveshjeje dhe transaksionet e parashikuara në këtë marrëveshje.

18.3 Vlefshmëria ligjore: kjo marrëveshje në të cilën ajo është palë, përbën detyrimet e tij të vlefshme ligjore, të zbatueshme në përputhje me kushtet e saj.

18.4 Ndryshime thelbësore me pasoja të rënda: nuk ka pasur ngjarje apo rrethana të cilat mund të shkaktojnë, ose mund të pritët në mënyrë të arsyeshme të shkaktojnë, baza për të besuar që nuk do të performojë (apo nuk do të jetë në gjendje të performojë) apo përmbushë një ose me shumë detyrime të tij thelbësore në bazë të kësaj marrëveshjeje.

18.5 Autorizimet: do të sigurojë që çdo organ shtetëror nën vartësinë direkte të qeverisë do të përmbushë plotësisht dhe në kohë detyrimet e tyre që rrjedhin nga klauzola 2.5 (autorizimet) e marrëveshjes së koncesionit.

#### 19. Kompensim pas zgjidhjes

Në rast të zgjidhjes së marrëveshjes së koncesionit, shumat përkatëse të kompensimit të pagueshme nga qeveria do të paguhet të plota dhe pa zbitje në llogarinë që Banka e njofton qeverinë në një kohë të përshtatshme me detyrimet e qeverisë kundrejt huamarrësit sipas kushteve të marrëveshjes së koncesionit.

#### 20.Të ndryshme

##### 20.1 Kushtet e marrëveshjes

Kjo marrëveshje do të qendrojë në fuqi deri në datën kur detyrimi i Bankës për të bërë disbursimet sipas marrëveshjes së huasë ka përfunduar në përputhje me kushtet e kësaj marrëveshjeje, ose nëse behet më vonë, derisa të gjitha paratë dhe detyrimet që ka huamarrësi, të pagueshme dhe të papaguara (në përputhmëri) sipas marrëveshjes së huasë dhe marrëveshjeve të tjera të financimit të jenë paguar plotësisht ose të shlyera në përputhje me dispozitat e kësaj marrëveshjeje.

##### 20.2 Veprimet nga Banka

Banka mund, herë pas here, si përpara ashtu dhe pas zgjidhjes së kësaj marrëveshjeje, me zgjedhjen e saj dhe pa njoftuar qeverinë, të ndërmarrë një nga veprimet e mëposhtme:

20.2.1 Të mbajë ose të sigurojë një interes sigurie mbi pasuri për të siguruar pjesë të borxhit kryesor.

20.2.2 Të mbajë ose të sigurojë detyrimet parësore ose dytësore të cilitdo detyrues ose detyrues në lidhje me pjesë të borxhit kryesor.

20.2.3 Të zgjasë ose të rinovojë për një ose më shumë periudha (më të gjata ose jo se periudha origjinale) të ndryshojë ose të shkëmbejë pjesë të borxhit kryesor, ose të lëshojë, të bjerë në kompromis për detyrime të çfarëdo natyre, të detyruesit në lidhje me pjesë të borxhit kryesor. dhe

20.2.4 Të heqë nga interesat e saj të sigurisë, dorëzohë, të heqë dorë apo lejojë zëvendësimin ose shkëmbimin për pjesë apo për të gjithë pronën, që shërben si siguri për borxhin kryesor, ose zgjasë dhe rinovojë për një ose më shumë periudha (më të gjatë ose jo se periudha origjinale) ose të lëshojë,

ndryshojë apo shkëmbejë detyrimet të natyrave të ndryshme të obliguesve në lidhje me këtë pronë.

#### 20.3 Marrëveshja e plotë, ndryshime dhe heqje dore

Kjo marrëveshje dhe dokumenteve të cilave ajo u referohet përbëjnë detyrimin e plotë të palëve të përfshira në këtë marrëveshje, në lidhje me objektin e kësaj marrëveshjeje dhe do të sipërkalojnë çdo shprehje qëllimi apo marrëveshje paraprake në lidhje me këtë transaksion. Çdo ndryshim në, heqje dorë nga Banka ndaj termave apo kushteve të, ose miratim i dhënë nga Banka në bazë të kësaj marrëveshje (përfshirë pa kufizim dhe klauzolën 20.3) do të jetë me shkrim, i nënshkruar nga Banka dhe në rast të ndonjë amendimi, dhe nga Qeveria dhe huamrresi.

#### 20.4 Njoftime

Çdo njoftim apo komunikim tjetër që jepet ose bëhet në bazë të kësaj marrëveshjeje do të jetë me shkrim. Njoftimet dhe komunikimet do të konsiderohen të dhëna dhe bëra siç duhet kur i dorëzohen dorazi, me postë, me telex, apo me faks, palës të cilës kërkohet që t'i dorëzohet në adresën e saj të specifikuar më poshtë, ose në një adresë tjetër të përcaktuar nga kjo palë nëpërmjet një njoftimi ndaj palës e cila bën njoftimin, aplikimin apo komunikimin.

Për Qeverinë e Shqipërisë:

Ministria e Ekonomisë  
Bulevardi Zhan D'Ark Nr.3  
Tirana  
Republika e Shqipërisë  
Në vëmendje të Ministrit  
Fax: 00355 422 2655

Dhe

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit  
Rruga "Abdi Toptani", nr.2  
Tirana  
Republika e Shqipërisë  
Në vëmendje të: Ministrit  
Fax: 00355 423 2389

For the Borrower:  
Tirana Airport Partners (TAP) (SHPK)  
Rruga e Kavajës nr.59  
Tirana Toëer  
Kati V  
Tirana  
Republika e Shqipërisë  
Në vëmendje të CEO and Managing Director  
Fax: 00355 422 4727

For the Bank:  
Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
One Exchange Square  
Londër EC2A2JN  
Angli  
Në vëmendje të:  
Fax: +44 -20-7338-6100

#### 20.5 Gjuha

Të gjitha dokumentet e dorëzuara dhe njoftimet e bëra nga qeveria apo Huamrresi në bazë të kësaj marrëveshjeje do të jenë në gjuhën angleze. Në rast se janë në gjuhë tjetër, do të shoqërohen nga një përkthim në anglisht i vërtetuar nga qeveria apo huamrresi, sipas rastit, i cili do të jetë versioni

mbizotërues për qeverinë, Huamarrësin dhe Bankën.

20.6 Të drejtat, mbrojtja ligjore dhe heqje dorë.

20.6.1 Të drejtat dhe mbrojtja ligjore e Bankës në lidhje me çdo keqpërfaqësimi apo shkelje të detyrimeve nga ana e qeverisë apo Huamarrësit nuk do të cenohen nga investigime nga apo në emër të Bankës në punët e qeverisë apo Huamarrësit, nëpërmjet zbatimit të kësaj marrëveshje apo çdo veprim tjetër që mund të kryhet nga ose në emër të Bankës në lidhje me këtë marrëveshje dhe që mund, përveç kësaj, vëre në rrezik këto të drejta dhe mbrojtje ligjore.

20.6.2 Asnjë procedurë apo vonesë në zbatimin, apo moszbatimin, i të drejtave fuqive apo mbrojtjeve ligjore të Bankës që rrjedhin nga kjo marrëveshje apo marrëveshje të tjera nuk do të zhvleftësojnë këto të drejta, fuqi apo mbrojtje ligjore dhe nuk do të konsiderohen si heqje dore prej tyre dhe as miratimi i tyre. Zbatimi i pjesshëm i këtyre të drejtave, fuqive, apo mbrojtjeve ligjore nuk përjashton zbatim tjetër apo të mëtejshëm të tyre apo zbatimin e të drejtave, fuqive dhe mbrojtjeve ligjore të tjera. Asnjë veprim i Bankës në lidhje me këtë mosveprim, apo miratim i saj për të, nuk do të influencojë apo dëmtojë të drejtat, fuqitë dhe mbrojtjet e Bankës që lidhen me mosveprime të tjera.

20.6.3 Të drejtat dhe mbrojtjet ligjore të përcaktuara në këtë marrëveshje janë kumulative dhe joeskluzive në raport me të drejta dhe mbrojtje të tjera që mund të rrjedhin nga ligje të zbatueshme apo tjetër.

20.6.4 Banka mund të mbrojë dhe zbatojë të drejtat e saj në bazë të kësaj marrëveshje në çdo gjykatë apo organ tjetër ankimimi nëpërmjet një veprimi ligjor, gjyqi të drejtë apo një procedure tjetër të përshtatshme, për dëme, zbatimin e një kushti specifik të marrëveshjes ose në mbështetje të zbatimit të një të drejte që i jep marrëveshja apo ligjo. Qeveria bie dakord t'i paguajë Bankës, me kërkesën e saj, shumën në monedhën e huasë të mjaftueshme për të rimbursuar Bankën për shpenzimet e lidhura me këto veprime dhe riparime, duke përfshirë të gjitha, tarifatat dhe shpenzimet e arsyeshme për këshillim ligjor.

20.7 Ligji mbizotërues

Kjo marrëveshje do të udhëhiqet nga dhe interpretohet në përputhje me legjislacionin e Anglisë.

20.8 Arbitrazhi dhe juridiksioni

20.8.1 Çdo grindje, mosmarrëveshje, apo pretendim që rrjedh nga apo lidhet me këtë marrëveshje, apo me shkeljen, zgjidhje apo pavlefshmërinë e saj do të zgjidhet me arbitrazh në përputhje me rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL-it, aktualisht në fuqi. Do të caktohet një arbitruer dhe autoriteti emëruer do të jetë Gjykata Angleze e Arbitrazhit Ndërkombëtar. Selia dhe vendi i Arbitrazhit do të jetë Londra, Angli dhe të gjitha procedurat e arbitrazhit do të zhvillohen në gjuhën angleze. Palët në këtë marrëveshje heqin dorë nga të drejtat dhënë nga ligji i Arbitrazhit 1996 për të apeluar vendimet e arbitrazhit në, apo të kërkojnë përcaktimin e një përcaktimi ligjor, nga gjykata e Anglisë. Gjykata e arbitrazhit nuk do të autorizohet të marrë apo të sigurojë, dhe qeveria dhe Huamarrësi bien dakord të mos kërkojnë nga autoritete gjyqësore, asnjë masë të përkohshme mbrojtëse apo marrë paravendimit kundër Bankës, pavarësisht dispozitave të rregullave të Arbitrazhit të UNCITRAL. Gjykata e arbitrazhit ka autoritetin të marrë në konsideratë dhe të përfshijë në çdo procedurë, vendim çdo grindje tjetër, cila i është paraqitur siç duhet nga Banka (por jo nga palët e tjera) për aq sa grindja rrjedh nga një marrëveshje financiare, por, në bazë të sa më sipërm, palë apo grindje të tjera nuk do të përfshihen në, apo konsolidohen me, procedurat e arbitrimin.

20.8.2 Pavarësisht klauzolës 20.8.1 më sipër, kjo marrëveshje dhe të drejtat e Bankës që rrjedhin apo lidhen me këtë marrëveshje, mund, me zgjedhjen e Bankës, të zbatohen nga banka në gjykatat e Anglisë apo Shqipërisë dhe çdo vend tjetër që ka juridiksion. Për të mirë të Bankës, qeveria dhe Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme pranojnë që gjykatat e Anglisë nuk kanë juridiksion eskuziv mbi grindjet, mosmarrëveshjet apo pretendime që rrjedhin apo lidhen me këtë marrëveshje, shkeljes, zgjidhjes apo pavlefshmërisë së saj. Qeveria këtu në mënyrë të pakthyeshme përcakton, emëron dhe fuqizon (o), në zyrën e tij të regjistruar në (o) Londër, Angli të veprojë si agjenti i saj i autorizuar për të marrë shërbime gjyqësore dhe thirrje ligjore në Angli në lidhje me veprime apo procedura ligjore të ndërmarra nga Banka në lidhje me këtë marrëveshje. Qeveria në mënyrë të pakthyeshme bie dakord me njoftim për proces apo thirrje tjetër ligjore dalë nga këto gjykata, të cilat i dërgohen me poste rekomande të parapaguar në adresën e përcaktuar më lartë. Qeveria bie dakord që, për sa kohë ka detyrime në bazë të kësaj marrëveshjeje, do të ketë një agjent të miratuar përkatësisht për të marrë njoftimet për gjyq dhe thirrje të tjera ligjore në Angli në lidhje me veprime apo procedura

ligjore të ndërmarra nga Banka që lidhen me këtë marrëveshje dhe do të informojë Bankën për identitetin dhe vendndodhjen e agjentit. Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të prekë të drejtën e Bankës të nisë veprime apo procedura ligjore kundër qeverisë apo huamarrësit në mënyrat e autorizuara nga ligjet e çdo juridiksioni të vlefshëm. Fillimi nga Banka i veprimeve apo procedurave ligjore në një ose me shumë juridiksione nuk i heq të drejtën Bankës të fillojë, njëkohësisht ose jo, veprime apo procedura ligjore në juridiksione të tjera. Qeveria dhe huamarrësi heqin dorë në mënyrë të pakthyeshme nga çdo kundërshtim që kanë ose mund të kenë, për çfarëdo arsye në lidhje me vendin e veprimit ose procedurës ligjore dhe çdo pretendim që ka ose mund të ketë më pas se ky veprim ose procedurë ligjore është adresuar në një forum të papërshtatshëm.

#### 20.9 Privilegjet dhe imuniteti i Bankës

Asgjë në këtë marrëveshje nuk do të interpretohet si heqje dore apo modifikim i imuniteteve, privilegjeve apo përjashtimeve të Bankës të cilat i jepen nga marrëveshja, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, konventë ndërkombëtare apo çdo ligj i zbatueshëm.

#### 20.10 Heqja e imunitetit sovran

Qeveria dhe Huamarrësi përfaqësojnë dhe garantojnë që kjo marrëveshje është një dokument më shumë tregtar se sa një dokument publik apo qeveritar dhe që as qeveria dhe as Huamarrësi nuk kanë të drejtën të kërkojnë imunitet kundër procedurave ligjore të filluara ndaj tij apo objekteve të tij, në bazë të çdo ligji apo juridiksioni ku veprimi mund të fillohet, për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin apo lidhen me këtë marrëveshje. Për aq kohë sa qeveria apo Huamarrësi apo çdonjë nga pronat përkatëse ka ose përfiton në të ardhmen të drejtën e imunitetit nga procedura të veçanta ligjore, bllokim përpara vendimit, bllokim tjetër apo zbatim vendimi mbi baza të sovranitetit apo tjetër, Qeveria dhe Huamarrësi heqin dorë nga imuniteti në lidhje me detyrimet e tyre përkatëse që rrjedhin apo lidhen me këtë dokument.

#### 20.11 Pasardhësit, të emëruarit dhe të drejtat e palëve të treta

20.11.1 Kjo marrëveshje lidh dhe detyron në të mirë të pasardhësve dhe të emëruarve përkatës të Palëve në marrëveshje, me përjashtimin që as qeveria dhe as Huamarrësi nuk mund të caktojnë apo transferojnë pjesë apo të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga ky dokument pa marrë më parë miratimin me shkrim të Bankës.

20.11.2 Banka mund të shesë, transferojë, caktojë, apo të përdorë në mënyrë tjetër të gjitha apo pjesë të të drejtave apo detyrimeve në bazë të marrëveshjes (përfshirë, pa kushte, të drejtën e pjesëmarrjes) pa miratimin e qeverisë apo huamarrësit. Pa kushtëzuar sa më lart, Banka mund të, herë pas here, pa njoftuar Qeverinë, caktojë apo transferojë pjesë apo të gjithë borxhin kryesor apo interesat lidhur me të dhe pavarësisht nga këto caktime apo transferime, ky borxh kryesor do të jetë dhe mbesë borxh kryesor për qëllime të kësaj marrëveshje dhe çdo caktim apo transferim i menjëhershëm i borxhit kryesor apo, interesa që lidhen me të, do të , në përputhje me interesin e caktimit apo transfertës në borxhin kryesor, ka të drejtën të përfitojë nga benefitet e kësaj marrëveshje në të njëjtën masë sikur i caktuari dhe i deleguari të ishte vetë Banka; gjithmonë, përveç kur Banka bie dakord me shkrim, Banka ruan të drejtën e paprekshme, parësore dhe superiore ndaj asaj të të caktuarve apo deleguarve të zbatojë këtë marrëveshje, për të mirën e Bankës, për atë pjesë të borxhit kryesor, të cilën Banka nuk e ka caktuar apo transferuar.

20.11.3 Përveç rasteve të parashkuara në 21.11.1 apo 21.11.2, asnjë nga kushtet e kësaj marrëveshje nuk mund të zbatohen nga palë të treta dhe persona që nuk janë palë nuk kanë të drejtë në bazë të marrëveshjes të zbatojnë apo të gëzojnë benefitet e kushteve të kësaj marrëveshjeje.

#### 20.12 Ekzemplarët

Kjo marrëveshje do të bëhet në shumë kopje, secila e vlerësuar si origjinale, dhe të gjitha bashkë do të përbëjnë një dhe të njëjtën marrëveshje.

Në dëshmi të sa më lartë, Palët në këtë marrëveshje, duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesve të tyre të autorizuar, nënshkruan këtë marrëveshje në emrat e tyre në datën e specifikuar më lartë.

Tirana Airport Partners (TAP) sh.p.k.

Nga:

Emri

Titulli

Qeveria e Republikës së Shqipërisë

Ministria e Ekonomisë  
Nga:  
Emri  
Titulli

Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit  
Nga:  
Emri  
Titulli

Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim  
Nga:  
Emri  
Titulli

## SHTOJCA 1 SHUMAT E GARANCISË

1. Palët në këtë marrëveshje bien dakord që të gjitha shumat e sigurimeve do të paguhen në llogarinë e sigurimeve, në përputhje me marrëveshjen e kushteve të përbashkëta.

2. Qeveria njih dhe bie dakord që çdo police sigurimi lëshuar dhe mbajtur nga Huamarrësi në bazë të klauzolës 21 (detyrimet e sigurimit) të marrëveshjes së koncesionit dhe/apo marrëveshjes financiare do të përfshijnë një klauzolë të humbjes të pagueshme dhe të njoftimit të anulimit, sipas formës të përcaktuar dhe shpjeguara në ... të marrëveshjes së huasë.

3. Nëse (i) nuk pritet të ndodhë rast mospërbushjeje, ose nëse ka ndodhur rast mospërbushje dhe vazhdon të përsëritet, huamarrësi mund (përveç në rastin e një humbje totale të vërtetë, të kompromentuar apo të sajuar) të përdorë shumat e pretendimit për humbje apo dëm fizik apo ndërprerje biznesi në mënyrën e mëposhtme:

(i) Nëse pretendimi përkatës (apo seria e pretendimeve që rrjedhin nga një shkak) në raport me humbjen apo dëmin fizik apo në raport me ndërprerjen e biznesit dhe në çdo rast e llogaritur veçantë është për shumë që nuk kalon pesëqind mijë euro (euro 500 000) (apo ekuivalentin e tyre në një monedhë tjetër me kursin e shkëmbimit të momentit), këto shuma mund të përdoren nga Huamarrësi vetëm për qëllim të rimbursimit të humbjes apo dëmtimit ose për të rivendosur ecurinë normale të projektit (ose në rastin e garancisë për ndërprerje biznesi, të kompensojë humbjen në të ardhura);

(ii) Nëse pretendimi (apo seria e pretendimeve që rrjedhin nga një shkak) në lidhje me humbje fizike apo dëmi apo në lidhje me ndërprerje pune dhe që, në çdo rast e llogaritur veçantë, kalon pesëqindmijë euro euro (euro 500 000) (apo ekuivalentin e tyre në monedha të tjera me kursin e shkëmbimit të momentit), këto shuma mund të përdoren nga Huamarrësi për të rivendosur ecurinë normale të projektit (ose në rastin e garancisë për ndërprerje biznesi, për të kompensuar humbjen në të ardhurat, nëse:

a) Huamarrësi dorëzon një raport Bankës në të cilin sqaron, me kënaqësinë e Bankës, që shumat e garancisë (të marra së bashku me të gjitha fondet e tjera në dispozicion të Huamarrësit) janë të mjaftueshme për të rimbursuar humbjet apo dëmet apo për të rivendosur kushtet e curisë normale të projektit (ose në rastin e garancisë për ndërprerjen e biznesit, për kompensimin e humbjes në të ardhura); dhe

b) Huamarrësi siguron prova të mjaftueshme për Bankën që shumat e garancisë do të përdoren vetëm për këtë qëllim.

4. Nëse çdonjëri nga kushtet e përcaktuara në paragrafin 3 nuk plotësohen, apo nëse krijohet një rast mospërbushje, banka me zgjedhjen e saj mund të përdorë të gjithë shumën e garancisë të mbledhura në llogarinë e shumave të garancisë si parapagesë për huatë e siguruar në bazë të marrëveshjes së huasë.

5. Në lidhje me shumat e marra vetëm për garancinë në rast ndërprerje biznesi nga Huamarrësi për një pretendim (apo një seri pretendimesh që rrjedhin nga një shkak), pavarësisht se ç'thuhet në këtë shtojcë, paragrafi 3(i) më lart, do të zbatohet për këstin e parë prej 500 000 euro dhe paragrafi

3(ii) do të zbatohet për atë pjesë të shumës së marrë që kalon 500 000 euro.

Përkufizime

Në shtojcën 1 fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimet e mëposhtme:

“Rastet e veprimeve bankare” ka kuptimin e dhënë në marrëveshjen e huasë

“Rast mospërbushje” ka kuptimin e dhënë në marrëveshjen e huasë

“Llogaria e shumave të sigurimit” do të thotë llogaria e krijuar dhe mbajtur në vijim të marrëveshjes së kushteve të përbashkëta

“Fondi i sigurimit” do të thotë të gjitha fondet e çdo pretendimi (apo seri pretendimesh që rrjedhin nga një shkak) në lidhje me humbje apo dëm fizik apo në lidhje me ndërprerje biznesi dhe në çdo rast e llogaritur veçantë në më shumë se pesëqindmijë euro (euro 500 000) (ose ekuivalenti në monedha të tjera me kursin e shkëmbimit të momentit) në lidhje me çdo rast apo seri rastesh të ndërmarra në bazë të sigurimeve (përveç detyrimeve publike apo sigurimeve të detyrueshme) që i paguhen ose merren nga Huamarrësi dhe/ose qeveria.

“Sigurimet” Do të thotë politikat e sigurimeve që nevojiten të hartohen herë pas here në përputhje me marrëveshjen e koncesionit dhe marrëveshjen e huasë.

“Data e pagesës së interesave” ka kuptimin e dhënë në marrëveshjen e huasë.

“Rast i mundshëm mospërbushje” ka kuptimin e dhënë në marrëveshje të huasë.



**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbraja ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL .....	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA .....	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 4.6.2010

Doli nga shtypi më 6.6.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2010

Çmimi 20 lekë